

Gjendet një granatë dorë në Tërpezë të Malishevës, FSK ka bërë eksplodimin e saj pa incident



29/08/2024 10:06

f

t

l

Një qytetar ka njoftuar Policinë se deri sa po groposte diçka pranë një peme në oborrin e tij në Tërpezë të Malishevës, ka hasur në një mjet të dyshimtë.

Mjeti ishte një granatë dorë, shkruan [lajmi.net](#).


Njësia policore e ka siguruar vendin e ngjarjes derisa aty ka dalë Njësia për Deminim e FSK-së qe e ka bërë eksplodimin e mjetit në mënyrë të kontrolluar pa ndonjë incident.

“**Terpezë, Malishevë / 28.08.2024 – 19:30.** Ankuesi kosovar ka njoftuar policinë se derisa ishte duke groposur afër një peme ka hasur në një mjet të dyshimtë (granatë dore). Njësia policore e ka siguruar vendin e ngjarjes derisa aty ka dalë Njësia për Deminim e FSK-së qe e ka bërë eksplodimin e mjetit në mënyrë të kontrolluar pa ndonjë incident”, thuhet në raportin e Policisë.

Më shumë nga uebi

nativeGRAM

by LajmiMedia



Artikuj të ngjashëm

